



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale  
Komisioneri

Nr. 33/1 Prot.

Tiranë, më 25/2 /2011

**Lënda:** Rekomandim për “Connex sh.p.k.”

REKOMANDIM

Nr. 33/1 ,datë 25/02/2011

Mbështetur në Ligjin nr.9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, Vendimet e Kuvendit të Shqipërisë nr.211, datë 11.09.2008 “Për zgjedhjen e komisionerit për mbrojtjen e të dhënave personale” dhe nr 225, datë 13.11.2008 “Për miratimin e strukturës organikës dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të zyrës së Komisionerit për mbrojtjen e të dhënave personale”, pas shqyrtimit të relacionit të Drejtorisë së Inspektimit në ngarkim të kontrolluesit, “Connex sh.p.k.”,

KONSTATOVA

Më datë 17.11.2010 nga grupi i inspektimit të Zyrës së Komisionerit është zhvilluar hetimi administrativ pranë kontrolluesit, “Connex sh.p.k.”, me cilësinë si kontrollues që mbledh dhe përpunon të dhëna personale në ushtrim të qëllimit dhe aktivitetit të tij, me objekt:

- Hetimi i procedurave të realizimit të mesazheve (sms) promovionale, të kryera nga ky kontrollues drejt numrave të telefonisë celulare të subjekteve të ndryshëm të të dhënave personale.
- Respektimi i kushteve të përcaktuara në ligjin nr.9887, datë 10.03.2008 “ Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, gjatë procedurës së realizimit të mesazheve promovionale (sms)..

Komisioneri “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” pasi shqyrtoi procesverbalin e hetimit administrativ të mbajtur me këtë rast si dhe provat e administruara vëren se:

Kontrolluesi “**Connex**”sh.p.k për të gjithë përdoruesit e numrave të telefonit celular me të cilat ai ka krijuar databasë, nuk ka një pëlqim të shprehur lidhur me ofrimin e shërbimit për dërgimin e komunikimeve tregtare me karakter reklame (ose promocion) përmes mesazheve të tipit sms.

Kontrolluesi “**Connex**”sh.p.k, gjatë aktivitetit të punës së tij me objekt “shërbime marketingu dhe komunikimi” ka dërguar komunikime tregtare me karakter reklame ose promocionale përmes mesazheve të tipit sms, për llogari të subjekteve të treta (Qendra Tregtare Univers (QTU),Scan Color Albania (Jysk), Caza Italia, Albania Motor Company (Ford),drejt numrave të ndryshëm përdoruesish të telefonisë celulare (AMC, Eëodafon, Eagle), pa marrë pëlqimin paraprak nga subjektet e të dhënave personale (mbajtës dhe përdorues të numrave të telefonave celularë) për ofrimin e këtij shërbimi.

- Në këtë rast nuk është zbatuar neni 6 pika 1/a i ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” “... Të dhënat personale përpunohen vetëm nëse subjekti i të dhënave personale ka dhënë pëlqimin”

Nisur sa më sipër në zbatim të neneve 29, 30 dhe 32 të ligjit nr.9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, si dhe 107-109 të K.Pr.Administrative ;

#### REKOMANDOJ

1. Shkatërrimin e database të krijuar nga Kontrolluesi “**Connex sh.p.k.**”, me numra të telefonave celularë të përdoruesve që nuk u është marrë pëlqimi, për përfshirjen e numrit të tyre të telefonit celular në këtë database.
2. Në zbatim të nenit 6 pika 1/a të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, ky kontrollues në të ardhmen të mos kryejë dërgimin e komunikimeve tregtare me karakter reklame (ose promocion) përmes mesazheve të tipit sms, drejt numrave të ndryshëm të telefonisë celulare të subjekteve të të dhënave (abonentë të kompanive AMC, Vodafon, Eagle ), pa marrë pëlqimin paraprak të tyre për ofrimin e një shërbimi të tillë.

Kryerja e këtyre rekomandimeve të rëndësishme për mbrojtjen e të dhënave personale që ju ngarkon ligji të realizohet menjëherë.

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin,

KOMISIONERI  
**FLORA ÇABEJ (POGAÇE)**

